

PROJEKTI SOCIAL

“SHKOLLA VERORE 2016”

Qëllimi:	Për të arritur një shkëmbim të suksesshëm të përvojave në drejtim të argëtimit, mësimdhënies, socializimit dhe edukimit sepse të gjithë kemi çfarë mësojmë nga njëri tjetri.
Kohëzgjatja:	3 javë mësimore
Fillimi i projektit.	Gusht 2016
Përfundimi i projektit	Gusht 2016

HYRJE

Në përputhje me prioritetet e Bashkisë së Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale është angazhuar për të mbështetur me projekte social-arsimore integruese grupe të fëmijëve, të cilët shfaqin tendenca për braktisjen e shkollës, për t'ju krijuar ambiente sa më miqësore, me qëllim integrimin dhe argëtimin e fëmijëve me probleme social-ekonomike.

Në qytetin e Tiranës, aktualisht gjenden 64 shkolla 9-vjeçare publike me 48408 nxënës. Bashkia e Tiranës ka prioritet të saj përmirësimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës së shkollave dhe mjediseve sportive nga nxënësit dhe komuniteti duke i ofruar organizimin e “Shkollave verore”. Përzgjedhja e shkollave është bërë mbi bazën e zonave të Tiranës ku problemet social-ekonomike janë më të theksuara si: Laprakë, Selitë, Kombinat, Allias etj, zona në të cilat shënohet edhe numri më i madh i braktisjeve shkollërore dhe numri më i madh i familjeve që kanë probleme social-ekonomike. Në të gjitha këto zona familjet e fëmijëve kanë ardhur kryesisht nga rrethet, sidomos nga zonat e varfra e të thella të vendit, si dhe familje rome dhe egjiptianë dhe vetëm një pakicë e tyre janë autoktonë.

SHTRIRJA E NDËRHYRJES:

Kjo ndërhyrje do të shtrihet në 7 shkolla publike 9-vjeçare të qytetit të Tiranës, të cilat janë identifikuar si të pozicionuara në zona me popullatë në gjendje të vështirë social-ekonomike. Projekti social i shkollave verore do të zhvillohet në 7 shkolla 9 – vjeçare, të renditura si më poshtë:

Shkollat 9-vjeçare

Nr	Shkolla 9-vjeçare	Njësia Administrative	Nr/Nxënësve
1	Shkolla “26 Nëntori”	Nr. 5	532
2	Shkolla “Naim Frashëri”	Nr. 7	576
3	Shkolla “Bajram Curri”	Nr.4	767
4	Shkolla “Shyqyri Peza”	Nr.6	1314
5	Shkolla “Xhezmi Delli”	Nr.3	214
6	Shkolla “28 Nëntori”	Nr.11	1112

KOHËZGJATJA E PROJEKTIT: 3 javë mësimore në muajin Gusht – gusht 2016

KONTEKSTI SOCIAL - EKONOMIK I KOMUNITETIT NË SHKOLLAT E PËRZGJEDHURA:

Përzgjedhja e shkollave është bërë në bazë të zonave të Tiranës ku problemet social-ekonomike janë më të theksuara: Laprakë, Selitë, Kombin, Allias etj, zona në të cilat shënohet edhe numri më i madh i braktisjeve shkollore. Në të gjitha keto zona familjet e fëmijëve kanë ardhur kryesisht nga rrethet, sidomos nga zonat e varfëra e të thella të vendit, si dhe familje romë dhe egjiptianë dhe vetëm një pakicë e tyre janë autoktonë. Familjet e këtyre fëmijëve janë të zhytur në një varfëri të tejskajshme e të ekspozuar ndaj disa problemeve si:

- Varfëri e thellë;
- Kushte të vështira banimi e higjienosantare;
- Papunësi;
- Niveli i ulët i arsimimit apo edhe mungesë arsimimi;
- Niveli i ulët social dhe kulturor i familjeve.

Si rrjedhojë e kësaj gjëndje janë shtuar dhe probleme të tjera sociale si:

- Dhuna brenda familjes
- Divorci
- Braktisja e arsimit të detyruar
- Punësimi i të miturve
- Lypja
- Trafikimi

Shkolla “26 Nëntori” ka 532 nxënës pjesa më e madhe e të cilëve vijnë nga familje me probleme ekonomike dhe sociale dhe një pjesë e mirë e nxënësve i përkasin komunitetit rom dhe jetojnë nën minimumin jetik. Nxënësit shfaqin probleme të shumta të cilat janë si pasojë e kushteve në të cilat jetojnë familjet e tyre.

Shkolla “Bajram Curri” ka 764 nxënës një përqindje e konsiderueshme e nxënësve janë nga komuniteti rom. Familjet e tyre mbartin probleme të thella sociale- ekonomike.

Shkolla “Qazim Turdiu” ka 1163 nxënës, një përqindje e konsiderueshme e nxënësve janë të ardhur nga zonat verilindore, pas vitit 1990. Familjet e tyre mbartin probleme të thella sociale- ekonomike.

Shkolla “Naim Frashëri” ka 576 nxënës, një përqindje e konsiderueshme e nxënësve janë të ardhur nga zonat verilindore, pas vitit 1990. Familjet e tyre mbartin probleme të thella sociale- ekonomike.

Shkolla “28 Nëntori” me 1112 nxënës. Kryesisht shkolla përbëhet nga fëmijë të ardhur nga rrethet të ndryshme të vendit të cilët janë në vështirësi social-ekonomike. Si rezultat i migrimit të popullsisë gjatë 10 viteve të fundit, në këtë zonë është rritur numri i popullsisë me familje, të cilat gjenden në vështirësi ekonomike dhe numri i fëmijëve që shkojnë në shkollë, duke krijuar mbipopullim të klasave dhe shkollave të Tiranës.

Probleme të njëjta social-ekonomike kanë edhe shkollat “Xhezmi Delli” me 214 nxënës, “Shyqyri Peza” me 1314 nxënës. Këto shkolla kanë të zhvilluar fenomenin e braktisjes. Përgjithësisht prindërit e ardhur nga rrethet ose janë prindër me përkatësi rome të cilët nuk janë të aftë të përballojnë vështirësitë për t’u integruar në sfidat e kryeqytetit. Në të gjitha zonat e propozuara ka fëmijë të paregjistruar, pasi për arsye ekonomike, shesin në rrugë, braktisin shkollën si rrjedhojë rrisojnë për duhan, drogë dhe dhunë.

Në përgjithësi mund të themi se të gjitha këto shkolla karakterizohen nga të njëjtat problematika ku më e spikatura është numri i konsiderueshëm i fëmijëve që vijnë nga familje që përballen cdo ditë me probleme të shumta social – ekonomike

METODOLOGJIA

“Shkollat verore” do të zhvillohen në ambientet e secilës nga shkollat e përzgjedhura.

Metodologjia e ndërhyrjes së këtij projekti bazohet në një përjasje edukative që vë në qendër fëmijën duke kuptuar nevojat e tij dhe duke i dhënë vlerë dinjitetit të tij si individ, raporti staf edukativ - fëmijë është i bazuar në të bërit e gjërave bashkë me fëmijën i cili është përfituesi i kryesor i ndërhyrjes së realizuar por dhe bashkudhëtar në procesin edukativ që në momentin e planifikimit të aktiviteteve dhe përgjatë tërë shtrirjes së projektit.

Realizimi i projektit të shkollave verore për vitin 2016, do të mbështetet edhe në eksperiencat dhe traditat e krijuara në organizimin e aktiviteteve shkollore duke ofruar si risi nxitjen e partneritetit Shkolla si Qendër Komunitare.

Projekti ka për qëllim ofrimin e një alternative edukative ndryshe ndaj ambienteve të pasigurta si rruga gjatë periudhës së verës duke mundësuar integrimin edukativ e kulturor, zbatimin, nxitjen e krijimtarisë të fëmijëve që vijnë nga familje me probleme social – ekonomike të qytetit të Tiranës, duke stimuluar bashkëpunim dhe ndërveprim, si dhe një proces të mësuarit sa më pak të lodhshëm dhe më tepër tërheqës. Kjo do të realizohet me anë të aktiviteteve të ndryshme edukative, krijuese, zbatuese e çlodhëse, të cilat do të realizohen në grupet artistike, sportive dhe edukative. Nga zbatimi i këtij projekti do të përfitojnë rreth 750 fëmijë, të zonave më të varfëra të 7 Njësisve Administrative të qytetit të Tiranës si dhe fëmijë romë dhe egjiptianë.

Një ndër pikat kyçe në realizimin e kësaj metodologjie do të jetë dhe raporti me familjet e fëmijëve të cilat janë të konsideruar si partnerë real të këtij projekti. Edukimi i fëmijëve në mënyrë informale nëpërmjet teknikave kreative, interaktive, argëtuese dhe reflektive mbi vlerat humane dhe rëndësinë e edukimit, frekuentimit të shkollës si dhe ndaj mjedisit ku ata jetojnë do të realizohet duke stimuluar gjithashtu krijimin e marrëdhënieve shoqërore mes fëmijëve, ndjesinë e të qenit pjesë e një grupi, bashkëpunimit, komunikimit në grup, si dhe zbulimin apo zhvillimin e talenteve apo aftësive të tyre.

Me qëllim arritjen e një performance sa më cilësore ky projekt parashikon edhe ofrimin e ushqimit, dhe pijeve freskuese për fëmijët që marrin pjesë në projekt, si një shërbim mbështetës edhe për familjet duke i bërë shkollat verore më miqësore dhe duke ndikuar dukshëm në zbutjen e fenomenit të braktisjes së shkollës.

Fëmijët e secilës prej shkollave do të jenë të angazhuar në 5 grupe : Letërsi dhe Teatër, Muzikë dhe Kërcim, Mozaik – pikturë, Sport, Ekologji. Këto aktivitete u japin mundësi fëmijëve për të zbuluar apo zhvilluar aftësitë e tyre në fusha të ndryshme. Mësuesit, të cilët drejojnë grupet si: letërsia dhe teatri, mozaiku - piktura dhe muzika do të angazhohen në zhvillimin e talenteve të fëmijëve sipas specifikës së grupit. Grupet: Mozaiku, Teatri, Ekologjia dhe Kërcimi do të prezantojnë punën e tyre në formë mini panairi dhe të paraqesin fituesin e teatrit të shkollës verore gjatë ceremonisë finale. Fëmijët me punimet e tyre më të

mira do të konkurojnë mes anëtarëve të grupit dhe fituesi do të konkurojë me fituesit e shkollave pjesëmarrëse në projektin “Shkolla verore 2016”.

Grupi i sportit synon zhvillimin e një mini-kampionati mes grupeve sportive të shkollave pjesëmarrëse të këtij projekti. Të gjitha këto teknika të grupeve jo vetëm që u japin një eksperiencë ndryshe fëmijëve, por u sigurojnë njohuritë e nevojshme dhe zhvillojnë aftësitë kreative dhe talentet e tyre. Këto teknika stimulojnë një edukim informal dhe formal tek fëmijët duke e bërë më tërheqës dhe më pak të lodhshëm procesin e të mësuarit dhe bashkëpunimin me mësuesin.

MENAXHIMI I PROJEKTIT PARTNERITETI (Burimet Njerëzore)

Roli	Numri i stafit	Partneri	Vërejtje
Realizimi i Projektit.			
Menaxher Projekti	1	DART	Drejtori i DART
Operatorë social	7	Bashkia Tiranë	Operatorë social nga Qendrat Sociale, Bashkia Tiranë
Animatorë	7 (nga një për shkollë)		Vetëm për ditët e premtë
Mësues	36 (7 shkolla x 5 mësues + 1 mësues)	Stafi i shkollave	Shkolla “26 Nëntori ka 5 + 1 mësues sepse ka më shumë nxënës pjesëmarrës në projekt)
Kordinatorë (drejtorët e shkollave)	7 nga një për shkollë	Stafi i shkollave	Është drejtori i shkollës pjesëmarrëse

Menaxheri i projektit i cili do të jetë përfaqësues i Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë do të merret me përzgjedhjen, organizimin dhe zhvillimin e trajnimit të mësuesve pjesëmarrës të shkollave që marrin pjesë në projekt. Për çdo shkollë do të selektohen nga 7 mësues që janë staf i shkollave të përzgjedhura dhe 7 kordinatorë të cilët do të jenë e drejtorët e shkollave të përzgjedhura. Fillimisht stafi i përzgjedhur do të organizojë një takim mbi prezantimin e projektit të shkollës verore dhe konkretisht të objektivave, metodologjisë së ndërhyrjes dhe aktiviteteve që do të organizohen si dhe rezultatet që duhet të arrihen. Aktivitetet do të zhvillohen në ambientet e shkollave të përzgjedhura.

Sensibilizimi dhe rekrutimi

Stafi i Shkollave të përfshira në projekt do të jenë të angazhuar në informimin e familjeve mbi objektivat dhe aktivitetet të cilat do të implementohen nga ky projekt si dhe rëndësinë e tij në edukimin dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre. Për këtë arsye do të zhvillohen këto aktivitete:

- Takime individuale me familjet
- Takime me bordin e prindërve të shkollave target
- Takime individuale dhe në grup me fëmijët, përfitues të projektit.

Animacioni: Ky projekt parashikon që fëmijët të kenë edhe hapësira për argëtim, por duke u edukuar dhe socializuar në menyre indirekte. Në ditën e pestë të javës mësimore do të

zhvillohen aktivitete animuese të llojeve: teknika dinamike grupi, lojra bashkëpunimi, lojra që stimulojnë komunikimin në grup, stafetë, kreative si dhe lojra qetësuese. Ky aktivitet do të lehtësohet nga animatorë të kontraktuar.

Qëllimi i këtij aktiviteti konsiston në rëndësinë që loja ka në rritjen e përgjithshme të fëmijës, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë psikologjik dhe afektiv. Ky aktivitet përmirëson aftësinë komunikuese dhe lidhëse të çdo fëmije që të mund të ndërtojë raporte pozitive me fëmijët e tjerë dhe me të rriturit.

Operatorë social: Ky projekt parashikon që fëmijët të kenë edhe hapësira për argëtim, por duke u edukuar dhe mbështetje psikosociale për tu përshtatur dhe zhvilluar me cilësi kreativitetin, aktivitet në funksion të programit të projektit. Secila shkollë pjesëmarrëse do të ketë të pranishëm cdo ditë një operator social i Qendrave Sociale në Bashkinë e Tiranës. Në çdo ditë të javës mësimore do të zhvillohen aktivitete argëtuese- rekreative, konkurse, të cilat do të mbështeten nga operatori për çdo shkollë mbi teknikat dinamiken grupi, lojra bashkëpunimi, lojra që stimulojnë komunikimin në grup, stafetë, kreative etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti konsiston në rëndësinë që loja ka në rritjen e përgjithshme të fëmijës, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë psikologjik dhe afektiv. Mbështetja nga operatorët socialë do të ndikojë në përmirësimin e aftësisë komunikuese dhe lidhëse të çdo fëmije që të mund të ndërtojë raporte pozitive me fëmijët e tjerë dhe me të rriturit.

Ndarja e fëmijëve në grupe

Fëmijët e secilës prej shkollave do të jenë të angazhuar në 7 grupe : Letërsi, Teatër, Muzike, Kërcim ritmik, Mozaik – pikturë, Sport, Ekologji. Ky aktivitet u jep mundësinë fëmijëve për të zbuluar apo zhvilluar aftësitë e tyre në fusha të ndryshëm. Mësuesit , të cilët drejtojnë grupet si: letërsia, teatri, mozaiku - piktura dhe muzika do të angazhohen në zhvillimin e talenteve të fëmijëve sipas specifikës së grupit. Grupet: Mozaiku, Teatri, Ekologjia dhe Kërcimi ritmik do të prezantojnë punën e tyre në formë mini panairi dhe të paraqesin fituesin e teatrit të shkollës verore gjatë ceremonisë finale. Fëmijët me punimet e tyre më të mira do të konkurojnë mes anëtarëve të grupit dhe fituesi do të konkurojë në ditën e ceremonisë finale me fituesit e shkollave pjesëmarrëse në projektin “Shkolla verore 2016”.

Grupi i sportit synon zhvillimin e një mini-kampionati mes grupeve sportive të shkollave pjesëmarrëse të këtij projekti. Të gjitha këto teknika të grupeve jo vetëm që u japin një eksperiencë tej jetë ndryshe fëmijëve, por u sigurojnë njohuritë e nevojshme dhe zhvillojnë aftësitë kreative dhe talentet e tyre. Këto teknika stimulojnë një edukim informal dhe formal tek fëmijët duke e bërë më tërheqës dhe më pak të lodhshëm procesin e të mësuarit dhe bashkëpunimin me mësuesin.

1. Grupi i Letërsisë dhe teatrit: Në këtë teknikë fëmijët do të zhvillojnë talentet e tyre në recitimin e poezive apo edhe monologjeve nga vepra të njohura të autorëve shqiptarë si dhe të huaj. Në këtë grup do të angazhohen edhe fëmijët që shfaqin aftësi krijuese letrare si në zhanrin e poezisë po ashtu edhe të prozës. Brenda grupit do të zhvillohet një konkurs për të zgjedhur recituesin më të mirë, i cili do e përfaqësojë këtë grup në konkursin final.

Gjithashtu me fëmijët e talentuar do të punohet dhe metoda e teatrit të rrugës që konsiston në faktin që fëmijët nuk janë vetëm aktorë. Nën lehtësimin e mësuesit fëmijët zgjedhin temën mbi të cilën duan të bazohet teatri dhe më pas zgjedhin pjesën teatrale, ndajnë rolet dhe mund të modifikojnë tekstin duke e sjellë veprën me një frymë të re. Pjesa teatrale, e cila duhet të

jetë prej maksimumi 15 minutash, do të prezantohet duke konkuruar mes grupeve të të gjithë shkollave.

2. Grupi i Mozaikut dhe i Pikturës: nën lehtësimin e mësuesit fëmijët zgjedhin pamjen mbi të cilën do të bazohet mozaiku. Mozaiku do të ndërtohet me anë të materialeve rrethanore. Qëllimi i kësaj teknike është që fëmijët të arrijnë të kuptojnë rëndësinë e materialeve të thjeshta. Mozaiku i përgatitur nga grupi do të prezantohet në sallën në të cilën do të zhvillohet ceremonia finale. Gjithashtu në këtë grup fëmijët do të jenë të angazhuar në punime vizatimi sipas temave të caktuara, të cilat do të zgjidhen nga mësuesit. Në javën e fundit të aktivitetit do të realizohet një ekspozitë me punimet e fëmijëve dhe do të zgjidhet piktura më e mirë.

3. Grupi i Muzikës dhe Kërcimit: Angazhimi i këtij grupi do të jetë në krijimin e një kori të drejtuar nga mësuesi përgjegjës për grupin. Gjithashtu në këtë grup do të tentohet të zhvillohen edhe talentet individuale të fëmijëve në këngë. Puna e këtij grupi do të prezantohet gjatë ceremonisë finale të shkollës verore, në të cilën do të zgjidhet kori ose këngëtari më i mirë.

Gjatë gjithë periudhës së shkollës verore, fëmijët, pjesëtarë të këtij grupi do të jenë të angazhuar në mësimin e një koreografie të zgjedhur nga mësuesi përgjegjës i grupit. Por gjithashtu fëmijëve do t'u jepet mundësia për të dhënë idetë e tyre në përmirësimin e koreografisë. Puna e këtij grupi do të prezantohet gjatë ceremonisë finale.

4. Grupi i Sportit: Ky grup do të funksionojë si një skuadër, e cila do të stërvitet gjatë 4 ditëve të javës dhe në ditën e pestë do të ndeshet me skuadrën e një shkolle tjetër. Të gjitha shkollat do të kenë skuadrën e tyre dhe do të jenë të angazhuara në një mini-kampionat futboll.

5. Grupi i Ekologjisë: Qëllimi i krijimit të këtij grupi është që fëmijët të kuptojnë rëndësinë e mjedisit ku ata jetojnë dhe të jenë edhe ata aktorë në mirëmbajtjen e tij. Gjatë gjithë kohës fëmijët anëtarë të këtij grupi do të jenë të angazhuar në pastrimin, gjelbërimin si dhe në zbukurimin e oborrit të shkollës së tyre. Procesi i punës së tyre do të fotografohet dhe në ceremoninë finale do të përgatitet një stendë, në të cilën do të shfaqen fotografite që prezantojnë punën e këtij grupi.

Ekskursione në vende të ndryshme

Gjatë periudhës së implementimit të projektit, fëmijët përfitues të projektit do të zhvillojnë 1 ekskursion ata do të kenë mundësinë të shohin e njohin objekte me vlera historike për qytetin tonë, sipas programit të hartuar dhe miratuar nga stafi i mësuesve. Nxënësit do të shoqërohen nga mësuesit e tyre si dhe nga operatorë dhe animatorë, të cilët do të zhvillojnë aktivitete të animacionit turistik

Projekti është i ndarë në tre faza: **Faza e parë** ka të bëjë me procedurat administrative. **Faza e dytë** ka të bëjë me sensibilizimin e ndërgjegjësimin mbi organizimin dhe realizimin cilësor të projektit. **Faza e tretë** ka të bëjë me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

MONITORIMI I PROJEKTIT:

Monitorimi i projektit do të realizohet përgjatë tërë zbatimit të tij, për këtë qëllim takime javore do të organizohen nga stafet zbatuese të projektit për çdo shkollë. Drejtorimi i Strehimit dhe Monitorimit do të monitorojë periodikisht sipas kalendarit të hartuar zhvillimin e aktiviteteve, si dhe do të hartojë raportin përfundimtar të vlerësimit të projektit “Shkolla verore 2016”, i cili do të përcillet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.

VLERËSIMI I PROJEKTIT.

Vlerësimi i projektit do të realizohet në mbyllje të projektit, saktësisht në tre ditët e fundit të muajit, dhe ky vlerësim do të realizohet në bashkëpunim me inspektorët e DART dhe specialistë të Drejtorisë së Drejtorimi i Monitorimit dhe Strehimit, të cilët kanë monitoruar zbatimin e projektit.

QËLLIMI

Për të arritur një shkëmbim të suksesshëm të përvojave në drejtim të argëtimit, mësimdhënies, socializimit dhe edukimit sepse të gjithë kemi çfarë mesojmë nga njëri tjetri.

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

1. Rritje e ndërgjegjesimit të opinionit publik dhe përfituesve për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
2. Ofrim shërbimesh: edukim, argëtim dhe zhvillim të fëmijëve, siguri fizike dhe përkujdesje.
3. Zbulimi dhe zhvillimi tek fëmijët i talenteve, interesave vlerave dhe prezantimi i punimeve të tyre në ekspozita dhe panairë.
4. Socializimi i fëmijëve në risk me fëmijë që ndjekin shkollën, nëpërmjet aktiviteteve argëtuese, artistike, sportive, etj.
5. sensibilizim i komunitetit për një mjedis të pastër në Tiranë.
6. Hapja e ekspozitave dhe minipaireve me punimet dhe krijimet e fëmijëve.
7. Integrimi i anëtarëve të komunitetit dhe grupeve të fëmijëve në nevojë.
8. Shkëmbim kulturash dhe traditash mes shkollave dhe komunitetit të këtyre zonave.

FAZAT E PROJEKTIT

Faza e parë

1. Miratimi i projektit në Këshill Bashkiak
2. Miratimi i preventivit dhe projektit “Shkolla verore 2016” nga Kryetari i Bashkisë Tiranë.
3. Tenderimi i preventivit të projektit “Shkolla verore 2016”.
4. Lidhja e kontratës së mirë përcaktuar me operatorin fitues.

Faza e dytë

1. Hartimi dhe miratimi i plan-veprimeve dhe klubeve për aktivitete të çdo shkolle nga koordinatori dhe menaxheri i projektit, për të përcaktuar me detaje në kohë dhe në vend zbatimin e planit të projektit.
2. Sensibilizimi i komunitetit, regjistrimi i fëmijëve sipas klubeve që pëlqejnë
3. Ndarja e materialeve sipas detajimeve dhe sistemimi i tyre në 7 pako për shpërndarjen, furnizimin dhe inventarizimin e 7 shkollave pjesëmarrëse në projekt.
4. Organizimi i tryezave të rrumbullakëta ku do të përzgjidhet aktivitetet e përbashkëta, kalendarin e eskursioneve, kampionateve dhe konkurseve ndërmjet shkollave.

Faza e tretë

1. Organizimi i aktiviteteve argëtuese dhe zbavitëse çdo ditë sipas klubeve
2. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me 7 shkollat dhe komunitetin
3. Organizimi i konkurseve dhe ceremonia e shpalljes së fituesve
4. Hapja e minipaireve dhe ekspozitave me punimet e fëmijëve në shkollat verore

5. Organizimi i ceremonisë së mbylljes së aktivitetit.
6. Monitorimi dhe raporti përfundimtar i vlerësimit mbi zbatimin e projektit “Shkolla verore 2016”, do të kryhet nga Drejtoria e Drejtorimit e Strehimit dhe Monitorimit.

PËRFITUES

Grupi i synuar do të jenë fëmijët që kanë probleme të shumta social-ekonomike dhe që kanë më shumë nevojë për integrim dhe janë më të riskuar ndaj fenomenit të braktisjes së shkollës, si dhe fëmijët Romë dhe Egjiptianë si nënkategori më e ekspozuar ndaj këtij fenomeni.

Përfitues të drejtpërdrejtë:

- Rreth 750 fëmijë të zonave periferike nga mosha 8-12 vjec në disa Njësi Administrative
- Përfituesit parësorë/direktë të këtij projekti janë rreth 750 fëmijë, vajza dhe djem, të cilët janë të përfshirë në shkollat e lart përmendura, te Njësi Administrative nr.3, nr.4, nr.5, nr.6, nr.7, nr.9, dhe nr.11 të qytetit të Tiranës.
- Përfituesit dytësorë/indirektë janë prindërit e këtyre fëmijëve, familjet e tyre dhe komuniteti.
- Koordinatorët, mësuesit, të cilët do marrin formim dhe do përfshihen në projekt.

